



# KUPA E KOMBIT 2023

## Disiplina "Enduro"

25-26 nëntor

### Formula Sportive e garës.

#### 1.0 ORARET E EVENTIT

- 1.1 25 nëntor  
Ora: 16:00 - 20:00, Kontrolli Administrativ.  
Ora: 17:00 - 20:00, Kontrolli Teknik i mjeteve dhe marrja e numrave.  
Ora: 20:30 - 21:30, Mbledhja shpjeguese me garuesit.
- 1.2 26 nëntor  
Ora 08:30 - 09:00, Përgatitja për start.  
Ora 09:00 - 10.00, Start i garuesve nga hoteli.  
*Çdo 30 sekonda, sipas listes së nisjes.*  
  
Ora 09:15, Nisja e xhiros së provës.  
Ora 09:45, Mbyllja e hyrjes për në xhiron e provës.  
Ora 10:30, Start i garuesit të parë.  
Ora 15:00, Mbyllja e garës.  
Ora 15:30, Ceremonia e ndarjes së çmimeve.

#### 2.0 IDENTIFIKIMI

- 2.1 Garuesit do të pajisen me tre numra stickers.
- 2.2 Një përpara dhe dy të tjerët majtas dhe djathtas në motor.
- 2.3 Marrja dhe ngjitja e numrit do të bëhet në procesin e kontrollit teknik.
- 2.4 Pas marrjes së numrit do të bëhet edhe montimi i transponderit RFID të kohëmatjes.
- 2.5 Në kontrollin teknik do të vendoset edhe Klasi përfundimtar i mjetit.

#### 3.0 TRACKING SYSTEM

- 3.2 Çdo garues do të pajiset me një transponder GPS/GPRS që shërben vetëm për monitorimin e lëvizjes së tij në trajektore.
- 3.3 Transponderi është me bateri dhe duhet mbajtur në xhep.
- 3.4 Transponderi do të jepet në momentin e startit.  
Depozitim financiar në rast humbje ose dëmtimi: 50 euro.
- 3.5 Në rast humbje ose dëmtimi, vlera prej 50 euro paguhet tek kompania që ofron shërbimin e monitorimit.

#### 4.0 NISJA

- 4.1 Rradha e nisjes do të bëhet sipas Klasit, në renditjen: E1/E2/E3
- 4.2 Brenda klasit do të bëhet sipas numrit të garës.  
Nga më i vogli tek më i madhi.
- 4.3 Rradha e nisjes nga hoteli; çdo 30 sekonda.
- 4.4 Rradha për nisjen e xhiros së provës; sipas rradhës së nisjes nga hoteli.
- 4.5 Koha e startit midis garuesve: çdo 20 sekonda.
- 4.6 Ora e nisjes së xhiros së provës; 09:15
- 4.7 Ora e mbylljes së hyrjes për xhiron e provës; 09:45

#### 5.0 GARA

- 5.1 Gara do të jetë 6 (gjashtë) xhiro të pistës.  
Gjatësia e xhiros 5.75 km.
- 5.2 Midis xhirove çdo garues do të ketë një kohë pushimi prej 5 minutash  
Pas pushimit, garuesi futet për xhiron e rradhës.  
Pas xhiros së parë, koha 30 sekonda nuk do të respektohet më por nisja do të bëhet në diskrecionin e arbitrave të startit.
- 5.3 Rradha e nisjes do të bëhet sipas Klasit, në renditjen: E1/E2/E3
- 5.4 Ora 10:30, Start garuesi i parë.  
Nisja e motorëve; çdo 30 sekonda.
- 5.5 Koha maksimale për kryerjen e garës: 4 orë, (plus 30 minuta).
- 5.6 Ora 10:30 - Nisja e garuesit të parë  
Ora 14:30 - Mbyllja e startit  
Ora 15:00 - Mbyllja e garës
- 5.6.1 Garuesit mund të paraqiten në start për t'u futur në xhiron e rradhës jo më vonë se ora 14:29:59.  
Pas kësaj ore nuk mund të futen dot më dhe për ta gara quhet e mbyllur.  
Koha e xhirove të mbetura pa kryer do të llogaritet sipas formulës së penalizimeve.
- 5.6.2 Garuesit kanë kohë për të mbaruar garën jo më vonë se ora 15:00:00.  
Garuesit që mbërrijnë pas kësaj ore, do t'u llogaritet koha e xhiros së fundit të kryer sipas formule së penalizimeve.

#### 6.0 PENALIZIMET

- 6.1 Mos paraqitja në kontrollin administrativ brenda orës 20:30, përbën skualifikim nga gara.
- 6.2 Moskalim i kontrollit teknik, përbën moslejim të pjesëmarrjes në garë.
- 6.2.1 Mosfirmosja e Kontratës së Pjesëmarrjes, përbën moslejim të pjesëmarrjes në garë.
- 6.3 Mosnisja për xhiron e provës deri në orën 09:45:00, garuesi e humbet të drejtën për të kryer xhiron e provës.
- 6.4 Koha minimale e pushimit midis xhirove; 5 minuta  
Koha maksimale për t'u nisur midis dy xhirove; 7 minuta
- 6.5 Mosmbarim i xhiros:  
Garuesi do marrë 150% të kohës më të lartë të asaj xhiroje që nuk mbaron.
- 6.6 Mosfutje në xhiro:  
Garuesi do marrë 200% të kohës më të lartë të asaj xhiroje që nuk futet.
- 6.7 Garuesit që kanë arritur të futen në xhiro deri në orën 14:30 por nuk e mbarojnë dot deri në orën 15:00, do të marrin 140% të kohës të xhiros së tyre të fundit.
- 6.8 Koha e garës do të jetë shuma e kohës së të gjitha xhirove që garuesi ka arritur të mbarojë brenda ores 14:59:59  
Xhirot e pakryera do të llogariten sipas formulave të mesipërme.
- 6.9 Në mes të xhiros ka një sektor prej 240 metrash që gara kalon në një rrugë çakulli me trafik, shpejtësia maksimale e lejuar për atë segment është 40 km/h.  
Në rast të kalimit të kësaj shpejtësie, garuesi merr një penalizim në kohë prej 60 sekondash, që do t'i shtohet në kohën e asaj xhiroje.

#### 7.0 TROFETË

- 7.1 Për garuesit që do arrijnë të nisen: Medalje.
- 7.2 Për tre vendet e para të çdo Klasi: Kupa për vendet 1/2/3.
- 7.2 Për renditjen e përgjithshme: Kupa per vendet 1/2/3.
- 7.3 Ceremonia do të zhvillohet pranë finishit të garës në oren 15:30

25-26 nëntor 2023

Federata Shqiptare e Motoçiklizmit